



Prishtinë: 14.12.2016
Kodi i ZRRE-së: V_871_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike LIGJI Nr. 05/L - 085;
- Dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1538_10_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **21.11.2016**.

në seancën e mbajtur më datë **14.12.2016**, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N. B. me shifër DFE - 6983 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1538_10_16** i datës 19.10.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.11.2016 ka pranuar ankesën e konsumatorit N. B. me të cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, i cili ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së anulimin e vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE numër ZRRE/DMK_V_1538_10_16 i datës 19.10.2016, dhe përgjigjen ndaj ankesës së konsumatorit së konsumatorit, në faturën e rikthimit të humbjeve , të sektorit për përkujdesje ndaj konsumatorit- divizioni i furnizimit KESCO të datës 07.06.2016 dhe faturën e rikthimit të humbjeve DFE16HP12235 të datës 13.05.2016, pasi që konsideron se Ndërmarrja e energjisë nuk i ka zbatuar ligjet dhe rregullat në fuqi, në atë mënyrë që ZRRE lëndën ta kthej në rishqyrtim. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se neni 39 i Ligjit për energjinë elektrike, nuk përcaktohet se procedurat e ankesës së konsumatorit por vetëm se përcakton veprimet të cilat paraqesin vepër penale që ndërliken me energjinë elektrike. Me këtë konsumatori në ankesë ka theksuar se bazuar në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë është parapa kompetenca e zgjidhjes së ankesave dhe kontesteve në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjes së energjisë elektrike.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se konsumatori N.B. fillimisht me datë 01.07.2016 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilën ka kundërshtuar



faturën e rikthimit të humbjeve DFE16HP12235 të datës 13.05.2016 në vlerë financiare prej **2.544.48 €** të ngarkuar nga KESCO për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve si organ i shkallës së parë në vendimin ZRRE/DMK_V_1538-10-16 të datës 19.10.2016 ka konstatuar se ankesa e parashtruar në ZRRE ka të bëjë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike e cila përbën vepër penale sipas nenit 61 të Ligjit të Energjisë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Shërbimeve Komunale ku ZRRE nuk ka mandat për shqyrtim dhe zgjidhje të kësaj ankese.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 14.12.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të theksuara në ankesë nga konsumatori dhe pas kësaj ka konstatuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Bordi ka shqyrtuar pretendimin e konsumatorit se organi i shkallës së parë DMK, nuk ka vendosur drejt në marrjen e vendimit pasi që i njëjti ka shpallë veten jokompetentë në pikëpamje lëndore dhe nga kjo nuk ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 17 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Lidhur me këtë Bordi ka konstatuar se nuk është kontestues fakti se dispozita e nenit 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë përcakton procedurat për zgjidhjen e kontesteve por që duhet kuptuar se ZRRE nuk ka mandat të shqyrtoj ankesat që kanë elemente të veprës penale apo shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike të parapara me nenin 61 të Ligjit të Energjisë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085.

Bordi gjithashtu ka konstatuar se edhe në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës kapitulli XXVI, përkatësisht nenet 319, 320, 321, 322, 323 dhe 324 i definojnë saktë veprat penale kundër shërbimeve komunale ku ndër to parashihet edhe vjedhja e energjisë elektrike, andaj mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë është vendosur se Zyra e Rregullatorit për Energji nuk ka kompetencë që të merret me shqyrtimin e ankesave që kanë elemente të veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se vendimi i Departamentit për konsumator në ZRRE, ka të bëjë vetëm me kompetencë lëndore që do të thotë se në këtë vendim nuk është shqyrtuar çështja meritore, gjithashtu në vendim nuk është konstatuar se konsumatori a është kryes i veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike apo jo, por vetëm se në bazë të provave të vërtetuara ka konstatuar se ZRRE nuk ka mandat ligjor për shqyrtimin e kësaj ankese.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka konstatuar se DMK në vendimin e saj me të drejt i është referuar dispozitës së nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative Ligji Nr. 02/L-28 për shkak të dërgimit të kërkesës te një organ që nuk ka kompetencë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 14.12.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N.B,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.